

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për programin e studimit MP “Shkenca juridike”, me profile: “E drejtë publike”, “E drejtë biznesi”, ofruar nga Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Asoc.Dr. Alketa Elezi



(Janar/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MP. "Shkenca juridike", me profile:

"E drejtë publike", "E drejtë biznesi"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	SHLUJ UMB
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 96, datë 27.1.2009
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASh Nr. 329, datë 07.08.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në "Shkenca juridike", me profile: "E drejtë publike", "E drejtë biznesi"
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
8	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve:	13 studentë
	etj	



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit MP. “Shkenca juridike”, me profile: “E drejtë publike”; “E drejtë biznesi”

Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca juridike”, me profile: “E drejtë publike”, “E drejtë biznesi”, ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike të Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti” (SHLUJ UMB). Ky program studimi është hapur si program studimi "Master i nivelit të dytë" (MND) në Shkenca juridike, me profile: i) E drejtë publike; ii) E drejtë e biznesit, me 60 kredite, për një kohëzgjatje 1 vjecare. Mbështetur në rekomandimin e Këshillit të Akreditimit (KA) lëshuar me Vendim Nr. 357, datë 13.07.2012, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), me Urdhër Nr. 329 datë 07.08.2012 vendosi akreditimin e programit të studimit. Me Shkresë Nr. 1167/2 Prot., datë 08.06.2011, Ministria e Arsimit dhe Shkencës konfirmon përshtatjen e programit të studimit në përputhje me ligjin 9741, datë 21.3.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” si program studimi Master Profesional. Më datë 26.03.2018, SHLUJ UMB ka paraqitur pranë ASCAL informacion për organizimin e programeve të studimit sipas departamenteve në UMB SHLUJ, sipas të cilit pranë SHLUJ UMB është i organizuar programi Master profesional (60 ECTS) në “Shkenca juridike”, me profile: “E drejtë publike”; “E drejtë biznesi”.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Dr. Eralda Methasani Çani dhe Prof. As. Alketa Elezi si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Për arsye shëndetësore të ekspertes Prof. Dr. Eralda Methasani Çani, procesi i vlerësimit vijoi vetëm me ekspertin Prof. As. Alketa Elezi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga specialistet e ASCAL: Znj. Majlinda Demirneli dhe Znj. Ersi Dako.

Më datë 28.01.2019, përmes sistemit AMS, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertët e vlerësimit. Më datë 30.01.2019, Institucioni, me shkresë Nr. 2463 Prot., datë 29.01.2019, kthen përgjigje në formë zyrtare, në të cilën shprehet se nuk ka komente për të. Sa më lart, Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit (Profili “E drejtë biznesi”):

Për profilin “E drejtë biznesi”, në Vendimin Nr.357, datë 13.07.2012, Këshilli i Akreditimit (KA) ka përcaktuar si rekomandime:

1. Të rritet numri i personelit akademik efektiv.
2. Të ofrohet një larmshmëri më e madhe e lëndëve që lidhen me institute të rëndësishme të së drejtës ekonomike në përgjithësi dhe tregtare në veçanti.
3. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

1. Për rekomandimin e parë, GVJ konstaton se SHLUJ “Universiteti Marlin Barleti” nga një raport pedagogësh 3 (tre) të brendshëm dhe 5 (pesë) të jashtëm/me kontratë, në vitin akademik 2012-2013, aktualisht rezulton se të gjithë pedagogët/stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi në këtë profil (6 pedagogë) janë të brendshëm, *duke e plotësuar atë plotësisht.*
2. Për rekomandimin e dytë, Institucioni ka reflektuar se ai realizohet individualisht nga secili pedagog duke trajtuar në auditor risitë që përmban legjislacioni në të drejtën ekonomike në përgjithësi dhe në të drejtën tregtare në veçanti. GVJ konstatoi se nga diskutimet në institucion është vlerësuar që të mos ketë ndryshim të programit për shkak të numrit të kufizuar të krediteve dhe shumëllojshmërisë objektive të programeve aktuale. Pavarësisht qëndrimeve të cilat janë mbajtur në diskutimet në institucion në referim të plan programit të këtij programi master, theksojmë nevojën për ta adresuar atë me vendimmarrje bazuar në analiza. Vlerësojmë se ky rekomandim konsiderohet *i plotësuar pjesërisht.*
3. Për rekomandimin e tretë, sipas Udhëzimit Nr. 52/2015, kriteri i njohjes së gjuhës së huaj për këtë nivel studimi nuk është detyrues, prandaj konsiderohet *i plotësuar plotësisht.*

III. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit (Profili “E drejtë publike”):

Për profilin “E drejtë publike”, në Vendimin Nr.357, datë 13.07.2012, Këshilli i Akreditimit (KA) ka përcaktuar si rekomandime:

1. Të rritet numri i personelit akademik efektiv.
2. Të rritet larmshmëria e lëndëve të ofruara në këtë program studimi në përshtatje me fushën e këtij programi.
3. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

IV. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

1. Për rekomandimin e parë “Të rritet numri i personelit akademik efektiv” GVJ konstaton se SHLUJ “Universiteti Marlin Barleti” nga një raport pedagogësh 2 (dy) të brendshëm dhe 6 (gjashtë) të jashtëm/me kontratë, në vitin akademik 2013-2014 (në vitin akademik 2012-2013 ky profil nuk u hap), aktualisht rezulton se janë 6 (gjashtë) pedagogë të brendshëm të

angazhuar në këtë program studimi dhe 2 (dy) janë të jashtëm/me kontratë, ***duke e plotësuar atë plotësisht.***

2. Për rekomandimin e dytë, Institucioni ka reflektuar se ai realizohet individualisht nga secili pedagog duke trajtuar në auditor risitë që përmban legjislacioni në të drejtën ekonomike në përgjithësi dhe në të drejtën tregtare në veçanti. GVJ konstatoi se nga diskutimet në institucion është vlerësuar që të mos ketë ndryshim të programit për shkak të numrit të kufizuar të krediteve dhe shumëllojshmërisë objektive të programeve aktuale. Pavarësisht qëndrimeve të cilat janë mbajtur në diskutimet në institucion në referim të plan programit të këtij programi master, theksojmë nevojën për ta adresuar atë me vendimmarrje bazuar në analiza. Vlerësojmë se ky rekomandim konsiderohet ***i plotësuar pjesërisht.***
3. Për rekomandimin e tretë, sipas Udhëzimit Nr. 52/2015, kriteri i njohjes së gjuhës së huaj për këtë nivel studimi nuk është detyrues, prandaj konsiderohet ***i plotësuar plotësisht.***



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca juridike”, me profile: “E drejtë publike”, “E drejtë biznesi” ka për qëllim të realizojë përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si jurist në fushën e të së drejtës së biznesit dhe të së drejtës publike. Kjo përgatitje, gjatë periudhës një vjeçare mbi nivelin Bachelor, ku merren bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të fituar kompetenca më specifike mbi një problematikë më të profilizuar, u krijon mundësinë studentëve të marrin njohuri më të thelluara në fushën përkatëse. Ky thellim i njohurive ndihmon juristët e rinj në një integrim më të lehtë në tregun e punës. Të diplomuarit në kuadër të këtij programi studimi do të marrin njohuri teoriko-praktike të nevojshme, me qëllim aftësimin e tyre: për të zotëruar një formim më të specializuar në fushën e të drejtës së biznesit dhe të së drejtës publike; për të qenë i aftë të trajtojë në mënyrë të efektshme çështje të së drejtës së biznesit dhe të së drejtës publike; të zotëroje teknikat e kërkimit dhe të arsytimit për të zgjidhur raste të ndërlikuara administrative dhe të biznesit. Në objektivat e strategjisë afatgjatë SHLUJ UMB ka si objektiv të zhvillojë, të përkrahë dhe të konsolidojë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor si edhe shërbime të tjera në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor të aplikuar. Departamenti i Drejtësisë synon domosdoshmërinë e lidhjes së drejtpërdrejtë të programeve të diplomave universitare me praktikën dhe tregun e punës. Për të realizuar këtë objektiv ndjek në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet si në rang kombëtar ashtu dhe europian me qëllim përshtatjen sa më të mirë të programeve me kërkesat e tregut të punës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit	Misioni dhe objektivat e programit të studimit janë në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit. Programi mundëson përgatitjen dhe hedhjen e bazave shkencore dhe përgatitjen teorike-praktike në përputhje me dinamikat dhe nevojat e zhvillimit të vendit si në fushën e së drejtës së biznesit ashtu edhe në atë publike. Mbështetur në kërkime të tregut të punës të realizuara nga SHLUJ UMB, programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe i përgjigjet kërkesave të kohës për formimin e e të diplomuarve me baza të mira teorike dhe praktike që synojnë liberalizimin e praktikave të funksionimit të biznesit dhe për përgatitjen e kornizës së re ligjore. Programi i studimit kontribuon direkt në
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblodhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.



	<p>përgatitjen e specialistëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin e modernizimin e vendit. Në këtë mënyrë, programi i studimit, megjithëse nuk ka të bëjë direkt me fushën e ruajtjes së vlerave kulturore të kombit, mbështet zhvillimet prioritare të kohës në Shqipëri duke mbajtur parasysh edhe orientimin e studentëve me kahje nga zhvillimi ekonomik e publik sigurisht duke patur parasysh specifikat e profileve përkatëse.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Në objektivat e strategjisë afatgjatë SHLUJ UMB ka si objektiv të zhvillojë, përkrahë dhe konsolidojë Programet e Masterave Profesionale dhe ti përshtasi me strategjinë për zhvillim të institucionit. Programet janë ndërtuar mbi programet bachelor. Synojnë të përgatisin specialistë të zotë në fushën e të drejtës publike dhe të biznesit brenda dhe jashtë vendit. Në këtë kuadër programi i studimit është përshtatur dhe ecën paralel me strategjinë për zhvillim të UMB.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit u përgjigjet kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (Ligji Nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”).</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Programet e studimit përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme për tu përshtatur me zhvillimet më të reja në këtë fushë me qëllim që të mbeten atraktive për studentët që synojnë regjistrimin në këto programe studimi. Kjo përputhet dhe me strategjinë afatgjatë të zhvillimit të UMB dhe Departamentit të Drejtësisë.</p> <p>Referuar takimeve me stafin akademik të programit të studimit, GVJ konkludon se UMB synon të përmirësojë punën e tij, përmes aktivizimit të një stafi akademik të kualifikuar dhe punon për aplikimin e metodave bashkëkohore për ta bërë mësimdhënien sa më të heqëse për studentët.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>1. Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca juridike”, me profile: “E drejtë publike”, “E</p>	

drejtë biznesi” është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, misionin dhe qëllimin e zhvillimit të SHLUJ UMB si dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në fushën e biznesit dhe të së drejtës publike.

2. Programi i studimit është hartuar në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit, bazohet në një plan strategjik për zhvillimin dhe përmirësimin e tij si dhe të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Programi i studimit MP. “Shkenca juridike”, me profile: “E drejtë biznesi”, “E drejtë publike”, ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike.

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike përbëhet nga tre departamente: Departamenti i Shkencave Politike; Departamenti i Drejtësisë; Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit.

Organi drejtues i Fakultetit është Këshilli i Fakultetit. Autoriteti drejtues i Fakultetit është Dekani, i cili është anëtar dhe Kryetar i Këshillit të Fakultetit. Sipas Statutit, Dekani i Fakultetit propozohet nga Senati Akademik mbi bazë të një procesi konkurimi [Statuti, Neni 37] dhe emërohet nga Rektori. Kontrata e punës lidhet me Administratorin e Deleguar [Statuti, Neni 43]. Senati Akademik përbëhet nga Rektori, Administratori i Deleguar, Zv/Rektori, dekanet e Fakulteteve, Drejtuesit e Instituteve Kërkimore të UMB, drejtuesit e Zyrave të Sigurimit të standarteve të cilësisë [Statuti, Neni 35, pika a] dhe të zgjedhur dy anëtarë nga çdo fakultet si përfaqësues të personelit akademik, një anëtar përfaqësues nga personeli administrativ dhe 2 përfaqësues nga Unioni Studentor [Statuti, Neni 35 pika b].

Dekanati është organ kolegjal i Fakultetit i cili drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga Dekani, Zv.Dekani dhe Përgjegjësit e departamenteve [Statuti, Neni 47]. Këshilli i Fakultetit përbëhet nga personeli akademik i Fakultetit dhe ka si funksione [Statuti, Neni 41-42]: i propozon Senatit strategjinë e zhvillimit të fakultetit; i propozon Senatit ndryshime në normat vjetore të ngarkesës mësimore dhe asaj kërkimore; i propozon Senatit ndryshime dhe përmirësime në kurrikulat nëpërmjet futjes së lëndëve, grup lëndëve ose moduleve të reja, zëvendësimit ose përditësimit të moduleve ekzistuese, shtrirjes ose grupimit të lëndëve në vite, rivlerësimit të krediteve të lëndëve etj; merr në shqyrtim dhe propozon strukturën mësimore të vitit akademik; i propozon Senatit dhënien e çmimeve, titujve të nderit dhe vlerësime të UMB për persona të veçantë; miraton rregulloret e departamenteve; shqyrton e vlerëson planet mësimore të fakultetit dhe programet e reja të studimit dhe ia paraqet Rektorit për miratim; rekomandon tekstet bazë për t’u përdorur nga ana e studentëve.

Departamenti i Drejtësisë në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Politike të SHLUJ UMB është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore. Objektivat e Departamentit të Drejtësisë lidhen me objektivat dhe veprimtaritë formuese të programeve të cikleve përkatëse të studimit [Statuti, neni 50]: shqyrton dhe harton planet mësimore dhe i propozon Këshillit të Fakultetit ndryshimet përkatëse; shqyrton dhe përpilon programet mësimore dhe bën ndryshimet e nevojshme; shqyrton dhe miraton tekstet bazë, tekstet plotësuese ose alternative dhe materiale të tjera didaktike për t’u përdorur nga ana e studentëve, dhe përgjigjet për vënien e tyre në kohë në dispozicion të studentëve; shpall fushat e specializimit, ato të kërkimit dhe të kualifikimit që udhëheq departamenti; organizon punën kërkimore dhe atë botuese të personelit akademik të departamentit; organizon mbështetjen dhe këshillimin e studentëve të vitit të fundit mbi mundësitë që ofron Departamenti për kualifikimin e mëtejshëm të tyre shkencor ose profesional; në përputhje me kërkesat dhe procedurat



përkatëse miraton kandidaturat për pedagogë me kohë të plotë dhe për punonjës kërkimorë; miraton rregulloret e programeve të studimit; shqyrton dhe harton planet mësimore dhe i propozon Këshillit të Fakultetit ndryshimet përkatëse.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike përbëhet nga tre departamente:

- 1) Departamenti i Shkencave Politike;
- 2) Departamenti i Drejtësisë;
- 3) Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Fakulteti në vitin aktual akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij 79 personel akademik efektiv dhe me kontratë (Tabela 1 e Ankeseve), prej të cilëve 31 janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 48 janë personel akademik me kontratë (PAK).

Departamenti i Drejtësisë në vitin akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij 14 anëtarë personel akademik efektiv dhe me kontratë, prej të cilëve 10 janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 4 personel akademik me kontratë. Nga personeli akademik efektiv, 7 prej tyre paraqiten me tituj/grada, ndërsa anëtarët e personelit akademik me kontratë paraqiten të gjithë me tituj/grada. (Tabela 1 dhe 2 e Anekseve).

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënljore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>SHLUJ UMB përbëhet nga 2 Fakultete: Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë. Çdo fakultet ka në përbërjen e tij të paktën tre departamente. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike përbëhet nga: Departamenti i Shkencave Politike, Departamenti i Drejtësisë dhe Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit. Sipas Statutit të IAL, Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore - kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura të njësive bazë.</p> <p>Departamenti i Drejtësisë ka në përbërjen e tij 10 pedagogë efektivë, nga të cilët 7 janë me tituj e grada.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe të drejtat e Departamentit janë të parashikuara në rregulloren e SHLUJ UMB dhe në rregulloren e programeve Master. Personeli akademik angazhohet dhe luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale. Departamenti është njësi bazë mësimore shkencore në Fakultet. Departamenti ka për detyrë të organizojë dhe të administrojë</p>

	veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Në përputhje me nevojat për staf akademik, Departamenti, paraqet kërkesat të cilat trajtohen sipas një procedure të mirëpërcaktuar e cila menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore.
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>1. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike përbëhet nga 3 Departamente: Departamenti i Shkencave Politike; Departamenti i Drejtësisë; Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit.</p> <p>2. Departamenti i Drejtësisë ka në përbërjen e tij 10 pedagogë efektivë, nga të cilët 7 janë me tituj e grada.</p>	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli Akademik përbëhet nga pedagogët me kontratë me kohë të plotë (PAE) si dhe personel akademik me kontratë (PAK). Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në kontratën e punës dhe në rregullore. Personeli Akademik është i angazhuar në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor sipas kërkesave dhe standardeve të SHLUJ UMB. Personeli akademik mund të angazhohet edhe me punë të tjera të natyrës administrative, në ndihmë të nevojave të Universitetit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat (Tabela 4.1 dhe 4.2 e Anekeve)

Profili “E drejtë biznesi”:

Për vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Shkenca juridike”, me profil: “E drejtë biznesi”, përbëhet nga **6** pedagogë gjithsej, të gjithë PAE, me kualifikimin **5** Dr/PhD., dhe **1** Msc.

Raporti PAE/PAK në këtë profil, për këtë vit akademik është **6/0**.

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë profil, për këtë vit akademik është **100%**.

Për vitin akademik **2016-2017** personeli akademik përbëhet nga **6** pedagogë gjithsej, nga të cilët **3** janë PAE dhe **3** janë PAK. Pedagogët PAE paraqiten me kualifikimin: **2** Dr/PhD. dhe **1** Msc., ndërsa pedagogët PAK paraqiten me kualifikimin **2** Prof.As. dhe **1** Msc.

Raporti PAE/PAK në këtë profil, për këtë vit akademik është **3/3**.



Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë profil, për këtë vit akademik është **50%**.

Për vitin akademik **2015-2016** profili “E drejtë biznesi” nuk është hapur.

Për vitin akademik **2014-2015** personeli akademik përbëhet nga **8** pedagogë gjithsej, nga të cilët **3** janë PAE dhe **5** janë PAK. Pedagogët PAE paraqiten me kualifikimin: **3** Dr/PhD., ndërsa pedagogët PAK paraqiten me kualifikimin: **1** Prof., **3** Dr/PhD., dhe **1** Msc.

Raporti PAE/PAK në këtë profil, për këtë vit akademik është **3/5**.

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë profil, për këtë vit akademik është **37.5%**.

Për vitin akademik **2013-2014** personeli akademik përbëhet nga **9** pedagogë gjithsej, nga të cilët **4** janë PAE dhe **5** janë PAK. Pedagogët PAE paraqiten me kualifikimin: **3** Dr/PhD., dhe **1** Msc., ndërsa pedagogët PAK paraqiten me kualifikimin: **1** Prof., **3** Dr/PhD., dhe **1** Msc.

Raporti PAE/PAK në këtë profil, për këtë vit akademik është **4/5**.

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë profil, për këtë vit akademik është **44.4%**.

Për vitin akademik **2012-2013** personeli akademik përbëhet nga **8** pedagogë gjithsej, nga të cilët **3** janë PAE dhe **5** janë PAK. Pedagogët PAE paraqiten me kualifikimin: **2** Dr/PhD., dhe **1** Msc., ndërsa pedagogët PAK paraqiten me kualifikimin: **2** Prof., **2** Dr/PhD., dhe **1** Msc.

Raporti PAE/PAK në këtë profil, për këtë vit akademik është **3/5**.

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë profil, për këtë vit akademik është **37.5%**.

Profili “E drejtë publike”:

Për vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar në profilin “E drejtë publike” përbëhet nga **7** pedagogë gjithsej, nga të cilët **5** janë PAE dhe **2** janë PAK. Pedagogët PAE paraqiten me kualifikimin: **1** Prof. As., dhe **4** Dr/PhD., ndërsa pedagogët PAK paraqiten me kualifikimin: **2** Dr/PhD.

Raporti PAE/PAK në këtë profil, për këtë vit akademik është **5/2**.

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë profil, për këtë vit akademik është **71.4%**.

Për vitin akademik **2016-2017** personeli akademik përbëhet nga **8** pedagogë gjithsej, nga të cilët **3** janë PAE dhe **5** janë PAK. Pedagogët PAE paraqiten me kualifikimin: **3** Dr/PhD., ndërsa pedagogët PAK paraqiten me kualifikimin: **1** Prof., **3** Dr/PhD., dhe **1** Msc.

Raporti PAE/PAK në këtë profil, për këtë vit akademik është **3/5**.

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë profil, për këtë vit akademik është **37.5%**.

Për vitet akademike **2015-2016** dhe **2014-2015**, profili “E drejtë publike” nuk është hapur.

Për vitin akademik **2013-2014** personeli akademik përbëhet nga **8** pedagogë gjithsej, nga të cilët **2** janë PAE dhe **6** janë PAK. Pedagogët PAE paraqiten me kualifikimin: **2** Dr/PhD., ndërsa pedagogët PAK paraqiten me kualifikimin: **2** Prof., **1** Prof.As., **2** Dr/PhD., dhe **1** Msc.

Raporti PAE/PAK në këtë profil, për këtë vit akademik është **2/6**.

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë profil, për këtë vit akademik është **25%**.

Për vitin akademik 2012-2013 profili “E drejtë publike” nuk është hapur.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator i programit të studimit

Këshilli Shkencor i Programit dhe Koordinator paraqiten në tabelën 3 të Aneksëve.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Të dhënat mbi kualifikimin e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe raportet midis tyre janë paraqitur sa më lart dhe në mënyrë të detajuar në tabelat 5.1. dhe 5.2. të Aneksëve.

- Të dhëna sipas moshës së personelit

Të dhënat mbi moshën e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi janë paraqitur në mënyrë të detajuar në tabelat 6.1. dhe 6.2. të Aneksëve.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, stafi akademik me grada dhe tituj si rregull kanë kontratë pa afat sipas parashikimeve të Ligjit “Për Arsimin e Lartë,” përveç rasteve të periudhës së provës. Pjesë e vlerësimit të stafit referuar kontratave të personelit janë disa aspekte: mësimdhënia, kërkimi dhe kontributi në projekte.

SHLUJ UMB ka një strukturë të posaçme të emëruar Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila ka krijuar një bazë të dhënash për personelin dhe vendet vakante të punës, që ndjek shpalljen e vendeve të lira, përpunimin e të dhënave etj. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përfshira në Statut për nivelet e larta të drejtimit (neni 28-30 i statutit), ndërsa për stafin tjetër sipas nenit 23 të statutit të UMB, është bordi që miraton kriteret kryesore arsimore për stafin që rekrutohet. Kriteret propozohen në varësi të vendit vakant nga strukturat përkatëse (epropri i drejtëpërdrejtë). Kontratat që nënshkruhen me pedagogët efektivë dhe ata me kontratë administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore e cila është përgjegjëse jo vetëm për arkivimin e dokumentacionit dhe ruajtjen e tij në vite, por edhe për gjenerimin e statistikave vjetore.

Nga takimi i realizuar në Zyrën e Burimeve Njerëzore nga GVJ dhe verifikimi i procedurës së rekrutimit për një numër rastesh [Evidencë minutat e vizitës në Institucion – Takimi me Z. Burimeve Njerëzore] rezulton se ndiqet procedura e parapërcaktuar për hartimin e kriterëve, ngritjen e komisionit të vlerësimit, regjistrimin e kandidatëve, intervistimin e tyre, shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Një politikë e tillë ka dhënë rezultate pozitive në drejtim të rekrutimit të stafit akademik dhe shërben si një bazë solide për një zhvillim të qëndrueshëm të tij. Në këtë mënyrë, gjatë vitit akademik 2017-2018 është rekrutuar një pedagogë efektive (me gradën Dr.)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	



<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>SHLUJ UMB ka të përcaktuara kritere për pajtimin në punë të personelit me kohë të plotë dhe atij me kontratë. Vlerësohet se personeli akademik angazhohet në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe përmbush detyrat e parashikuara në kontratën e punës. Përveç procesit të mësimdhënies, personeli është i angazhuar edhe në veprimtari administrative dhe mbështetëse.</p> <p>Personeli akademik, ndihmës dhe administrativ i UMB-së është angazhuar në zbatimin e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Këto detyra janë të parashikuara në kontratë ose të dhëna sipas nevojave institucionale.</p>
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Vendimet për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave merren me propozim nga Departamenti i Drejtësisë i cili ideon dhe kontribuon në hartimin e kurrikulës së programit. Kur vendimi miratohet në nivel Departamenti kalon për miratim në instancat më të larta.</p> <p>Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me rregullat e brendshme të SHLUJ UMB.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Institucioni ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë parimet, kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik si dhe ndjek procedura ligjore dhe transparente. Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e UMB është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të rekrutimit të personelit dhe bashkëpunon ngushtë me zyrën e rektorit si dhe me administratorin.</p> <p>Në profilin “E drejtë publike”, në vitin akademik 2017-2018 janë të angazhuar 5 pedagogë PAE dhe 2 pedagogë PAK, në një raport numerik 71.4 % PAE / 28.6 % PAK. Personeli akademik efektiv mbulon 83.3 % të ngarkesës totale mësimore. Në vitin akademik 2016-2017, raporti numerik PAE/PAK është 37.5 %/62.5 %. Personeli akademik efektiv në këtë vit akademik ka mbuluar 66.7 % të ngarkesës totale mësimore.</p>

	<p>Në profilin “E drejtë biznesi”, në vitin akademik 2017-2018, i gjithë stafi akademik i angazhuar është staf efektiv dhe për rrjedhojë ngarkesa mësimore mbulohet 100 % nga staf akademik efektiv.</p> <p>Në vitin akademik 2016-2017, raporti numerik PAE/PAK është 50%/50 %.</p> <p>Personeli akademik efektiv në këtë vit akademik ka mbuluar 58.3 % të ngarkesës totale mësimore.</p> <p>UMB ndjek procedura transparente të vlerësimit të personelit. Procedura kryhet në mënyrë periodike nga departamentet ose nga rektorati.</p> <p>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore disponon një bazë të dhënash për të gjithë personelin akademik efektiv dhe atë me kontratë, si dhe të dhëna për njoftimet për punë dhe procesin e rekrutimit të personelit.</p>
--	---

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit mban gradën shkencore Doktor dhe ka përvojë të gjatë akademike.</p> <p>Të gjithë titullarët e lëndëve/moduleve në këtë program studimi kanë gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Në këtë program studimi, në profilin “E drejtë publike” japin mësim 1 Prof. As dhe 6 Dr./PhD., ndërsa në profilin “E drejtë biznesi” japin mësim 5 Dr/PhD., dhe 1 Msc.</p> <p>Rektori, Zv/rektori, Dekanët e Fakulteteve, Përgjegjësit e Departamenteve, Drejtorët e Instituteve dhe të Qendrave janë të punësuar me kohë të plotë në SHLUJ UMB.</p> <p>Institucioni ka personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>
---	--

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i



Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe takimet e realizuara në Institucion rezultoi se studentët, në përmbyllje të programit të studimit, kryesisht i nënshtrohen provimit. Studentët me mesatare mbi 9.5 mund të përmbyllin studimet nëpërmjet mikrotezës. Studentët të cilët mbrojnë temë, kanë një udhëheqës për punën e tyre kërkimore. Udhëheqësit kanë së paku gradën shkencore Dr.</p> <p>Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht, lidhur kjo dhe me numrin e limituar të studentëve që përmbyllin studimet me temë diplome. Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Institucioni, vetëm 8 studentë në këtë program kanë përmbyllur me temë diplome [Evidencë: Lista e temave të masterit dhe udhëheqësit].</p>
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Pedagogët e angazhuar në këtë program studimi janë të specializuar në një fushë studimore-kërkimore, të njëjtë apo në përputhje me fushën studimore të këtij programi studimi. Institucioni i jep prioritet fushës studimore kërkimore të pedagogut udhëheqës dhe interesit studimor të studentit. Nga viti 2016, në përputhje me ligjin e ri të arsimit të lartë, titulli master profesional mbrohet edhe me provim formimi (udhëzimi i rektorit nr.18 datë 18.01.2016).</p> <p>Departamenti gjatë shqyrtimit të propozimeve për temën e diplomës garanton që udhëheqësi i propozuar të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe temën e propozuar dhe të zotërojë njohuritë e duhura teorike me aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimit.</p>
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni ka personel ndihmës për pajisjet e teknologjisë mësimore i cili u asiston gjithë rrjetin e internetit dhe pajisjet kompjuterike në laboratorin e informatikës.</p> <p>UMB ka pozicione të ndryshme pune për shërbimet. Nga takimet me personelin e Institucionit evidentohet një politikë e mirë për menaxhimin e burimeve njerëzore që janë plotësisht të angazhuar për të përmbushur</p>

	objektivat e programit.
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se ngarkesa mësimore realizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe kontratës së lidhur me SHLUJ UMB e cila ka përcaktuar ngarkesën mësimore si dhe elementet e tjera të ngarkesës së punës.</p> <p>Ngarkesa mësimore e personelit është e llogaritur në orë mësimore sipas dokumentit të ngarkesës mësimore të SHLUJ UMB.</p>
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në Zyrën e Burimeve Njerëzore rezultoi se ajo disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, duke përfshirë dosjen personale, të dhënat për ngarkesën mësimore apo të dhënat për kërkimin shkencor.</p> <p>Përveç kësaj zyre, informacion të plotë për personelin ka edhe Departamenti, Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, Sekretaria Mësimore Master.</p> <p>UMB ka të përcaktuara dhe publikuara kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit. ZBNJ shpall periodikisht në faqen zyrtare të Institucionit ose edhe në media, në varësi dhe të kërkesave institucionale, vendet vakante.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Gjatë vitit të fundit akademik 2017-2018, Institucioni ka rekrutuar personel të ri akademik efektiv duke bërë të mundur rritjen e numrit të personelit akademik me tituj e grada. 2. Në vitin akademik 2017-2018, në të dyja profilet e këtij programi studimi, ngarkesa mësimore e mbuluar nga personeli akademik efektiv është mbi 70 %, por në vite të tjera paraardhëse kjo ngarkesë jo gjithmonë është plotësuar. 3. Personeli akademik me kontratë, paraqet qëndrueshmëri në vite dhe duke qenë personel i kualifikuar ka treguar përkushtim në realizimin e programit. 4. Institucioni disponon të dhëna të detajuara përsa i takon personelit akademik të angazhuar, formën e punësimit dhe ngarkesën e realizuar. 5. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit dhe publikon njoftimet për vendet vakante. 6. Studentët me mesatare mbi 9 të cilët përmbyllin studimet me temë diplome kanë një udhëheqës për punën e tyre kërkimore, i cili ka së paku gradën shkencore Dr. dhe nuk mbikëqyr më shumë se 5 studentë njëkohësisht. 	

4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë e Fakultetit të Drejtësisë, Shkencave Sociale e Politike e zhvillon aktivitetin në dy kampuse. Në kampusin 1 janë përqëndruar studimet bachelor dhe administrata, ndërsa në kampusin 2 dytë studimet master. Kampusi 2 është në shërbim të programeve të studimit master të Fakultetit, ka ambiente të përshtashme për zhvillimin e procesit mësimor si dhe ofron shërbime suplementare si bibliotekë, mjedis çlodhës (kafeteri), mjedis për fotokopjime, mjedise sportive, Dekani i Studenteve etj.

Nga vëzhgimi i ambienteve gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se ato janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor. Sallat e leksioneve janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike si videoprojektor, ekrane projektimi etj. Mënyra e realizimit të mësimdhënies bazohet në metoda e teknologji bashkëkohore.

Biblioteka në dispozicion të studentëve të Fakultetit ofron një numër të kufizuar titujsh për të mbuluar programet e studimeve të ofruara. Synohet disponibiliteti i literaturës bazë në gjuhën shqipe, por shfrytëzohen edhe libraritë elektronike të cilat përmbajnë libra apo botime shkencore. Përgjithësisht për secilën lëndë apo njësi lëndore, pedagogu i udhëzon studentët për literaturën bazë dhe për literaturën e rekomanduar [Takimi me stafin akademik]. Në literaturën bazë rekomandohen edhe tekste të përkthyer nga shtëpi të ndryshme botuese, si dhe tekste në gjuhë të huaj. Në çdo rast, pedagogu u ofron studentëve leksionet e tij të shkruara [Takimi me stafin akademik]. Në bibliotekë janë të instaluar terminale të lidhura në një kompjuter qendror, të cilët vihen në dispozicion të studentëve, duke i mundësuar atyre kërkimin në internet dhe aksesimin e librarive *online* të këshilluara nga departamenti.

Mjediset për Programin e studimit (Tabela 7 e Anekeve)

Departamenti i Drejtësisë zhvillon aktivitetin e tij në dy kampuse. Për programin MP. Shkenca juridike, me profile, aktiviteti është kryesisht i përqëndruar në Kampusin 2. Kampusi ka ambiente të përshtashme për zhvillimin e procesit mësimor si dhe ofron shërbime suplementare si bibliotekë, mjedis çlodhës (kafeteri), mjedis për fotokopjime, mjedise sportive, Dekani i Studenteve, Zyra e Alumni dhe Karrierës, etj.

Mjediset për stafin (Tabela 8 e Anekeve)

Mjediset për mësimdhënie janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor. Sallat e leksioneve janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike si videoprojektor, ekrane projektimi etj. Mënyra e realizimit të mësimdhënies bazohet në metoda e teknologji bashkëkohore.

Vlerësimi sipas Standardeve


Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike e zhvillon aktivitetin e tij në dy kampuse me vendndodhje të përhershme.</p> <p>Mjediset janë pronë e aksionerëve të SHLUJ UMB.</p> <p>Programi Master Profesional në “Shkenca juridike”, me profile: “E drejtë publike”, “E drejtë Biznesi” zhvillohen në 2 godina të veçanta. Në kampusin 1 ndodhen zyrat e departamentit të drejtësisë, ndërsa në kampusin 2 gjenden auditorët e zhvillimit të leksioneve. Ambientet janë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor si dhe ofrohen shërbime suplementare si bibliotekë, zyrë informacioni për studentët, mjedis çlodhës (kafeteri), mjedis për fotokopjime, etj.</p>
---	--

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët GJVJ konstatoi se pedagogët u rekomandojnë studentëve tekste mësimore që shërbejnë si literaturë bazë si dhe leksione dhe materiale të tjera ndihmëse.</p> <p>Gjatë vizitës tek biblioteka u konstatua se nuk ka mjaftueshëm disponibilitet të literaturës bazë në gjuhën shqipe.</p> <p>Ka librari elektronike të cilat përmbajnë libra apo botime shkencore por jo të gjitha botimet apo publikimet janë të përditësuara [Takimi Biblioteke]. SHLUJ UMB boton revistën “Gjeopolitika” e cila botohet periodikisht çdo gjashtë muaj dhe trajton çështje të lidhura me shkencat juridike, shkencat politike dhe ekonomike.</p> <p>Nga takimi me stafin akademik dhe drejtuesit e institucionit u konfirmua se ata çdo vit akademik porositin tekset e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Departamenti i Drejtësisë, bazuar edhe në azhurnimet vjetore të programeve të lëndëve nga ana e pedagogëve titullarë, duhet të hartojë një plan të detajuar (dhe buxheti përkatës) me librat e rinj me të cilët konsiderohet e nevojshme të pasurohet biblioteka për t’ju ardhur në ndihmë studentëve dhe për t’i mbajtur të azhurnuar me zhvillimet më të fundit të programeve përkatëse.</p> <p>Biblioteka ofron shërbim të kënaqshëm për studentët dhe qëndron gjatë orëve që zhvillohet programi i studimit.</p>
--	---

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.



<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Konstatimi i GVJ është se mjediset aktuale janë të përshtatshme dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Kampusi 2 i venë në dispozicion të programit master është i pajisur me salla leksionesh, seminaresh, të cilat janë të pajisura me kompjutera dhe projektorë të nevojshëm për realizimin e procesit mësimor.</p> <p>Mjediset mësimore janë të pajisur me mjetet e nevojshme për një mësimdhënie cilësore në përputhje me qëllimet dhe objektivat e programit të studimit.</p> <p>Laboratorët kanë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit.</p> <p>Masteri “Shkenca juridike”, me profile: “E drejtë publike” dhe “E drejtë biznesi” nuk parashikon praktika laboratorike.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. GVJ vlerëson se mjediset aktuale janë të përshtatshme dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Infrastruktura që është në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Godina disponon një infrastrukturë moderne. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me kompjutera dhe projektorë të nevojshëm për realizimin e procesit mësimor. 2. Biblioteka përgjithësisht ofron kushte të mira por ka një numër të kufizuar titujsh për të mbuluar programin e studimit. U konstatua se nuk ka mjaftueshëm disponibilitet të literaturës bazë në gjuhën shqipe. Ka biblioteka on-line dhe librari elektronike të cilat përmbajnë libra apo botime shkencore por jo të gjitha botimet apo publikimet janë të përditësuara. 	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit. Të gjitha këto të ardhura shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese. Në rang universiteti ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare dhe kontrollin e tyre.

Pjesa tjetër e të ardhurave realizohet nga aktivitetet e shërbimit, konsulencës, trajnimit, etj.

Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR.

Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm (audit i jashtëm) [Pasqyra financiare dhe Raport eksperti kontabël].

Sipas RVB [faqe 48], kostoja për një student në programin e studimit është 1150 Euro.

Eventualisht institucioni mund të punojë në drejtim të diversifikimit të burimeve të financimit, duke mos u kufizuar vetëm tek tarifat e shkollimit, por duke ofruar shërbime për të tretët, duke u angazhuar në projekte shkencore si dhe eventualisht projekte zbatimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>SHLUJ UMB bën një audit të përvitshëm nga ekspertë financiarë, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik.</p> <p>Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet dhe të ardhurat (duke ju referuar bilancit). Aktualisht universiteti nuk përfiton ndonjë grant të huaj.</p> <p>Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet.</p> <p>Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare i referohet të gjithë institucionit si një njësi e vetme.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Zyra e Financës të SHLUJ UMB harton çdo vit një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, etj.</p> <p>SHLUJ UMB dëshmon një qëndrueshmëri financiare. Eventualisht, në të ardhmen, mund të punohet në drejtim të diversifikimit të burimeve të financimit.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. GVJ vlerëson se në mënyrë të përvitshme hartohet një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve. 2. GVJ vlerëson se duke ju referuar raportit financiar zyrtar SHLUJ UMB ka një bilanc vjetor pozitiv, i cili garanton ecurinë perspektive të programeve të studimit. Konstatohet qëndrueshmëri financiare e SHLUJ UMB por në të ardhmen mund të punohet në drejtim të diversifikimit të burimeve të financimit. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Mbështetur në dokumentacionin në RVB, dokumentacionin mbështetës të SHLUJ UMB dhe atë të marrë gjatë vizitës në institucion rezulton se pranë UMB funksionon Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, e krijuar me vendimin Nr. 50, datë 08.05.2018 të Rektorit të UMB. Kjo zyrë ka si qëllim të ndjekë vijimësinë e proceseve themelore që ndikojnë në realizimin e plotë të procesit akademik dhe në zhvillimin afatshkurtër e perspektiv të kurrikulave universitare të UMB, proceset themelore të vlerësimit të cilësisë dhe akreditimeve programore e institucionale, mbështetur në dokumentacionin ligjor të arsimit të lartë dhe aktet nënligjore të MASR dhe aktet e tjera nënligjore, vendimore e udhëzuese të strukturave qeverisëse të institucionit. Me vendimin Nr. 38, datë 06.03.2016 të Rektorit të UMB, është ngritur dhe funksionin gjithashtu Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, i cili funksionon në nivel institucioni. Komisioni është i përbërë nga 4 anëtarë dhe ka përgjegjësinë e garantimit të plotësisë të standardeve të cilësisë. Ky komision mund të plotësojë edhe me një student për të dhënë frymën e gjithë përfaqësimit. Komisioni i raporton drejtpërdrejtë në Senat. Gjithashtu, në UMB funksionon edhe Këshilli i Vlerësimit të Performancës, i cili funksionon prej 1 viti dhe përbëhet prej 6 anëtarësh të cilët janë staf akademik. Ky organizëm bashkëpunon me Zyrën e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë për të siguruar informacion për stafin akademik dhe për të siguruar një vlerësim të performancës së stafit akademik. Këshilli jep rekomandime për performancën e stafit akademik, të cilat ja drejton Rektorit dhe përgjegjësve të njëjësive kryesore.

Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë kryen anketime periodike dy herë në vit, me secilin grup studentësh, dy javë përpara përfundimit të semestrit. Numri i studentëve që kryejnë anketimin jo gjithmonë përputhet me numrin e studentëve që frekuentojnë një lëndë duke qenë se kryhet vetëm me ata studentë që janë të pranishëm në momentin e plotësisë të tij. Procesi i anketimit vijon me përpunimin e të dhënave, rezultatet e të cilave i paraqiten Rektorit dhe gjithashtu u bëhen me dije stafit akademik në mënyrë individuale si dhe studentëve. Gjithashtu, mënyrë tjetër vlerësimi janë edhe mendimet e pedagogëve të jashtëm. Hap i ndërmarrë nga SHLUJ UMB në funksion të përmirësimit të sigurimit të cilësisë është përfshirja e tij në projektin Erasmus+ QAINAL.

Në SHLUJ UMB kontrolli i brendshëm i cilësisë angazhon disa organizma siç janë Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, krijuar me vendimin Nr. 50, datë 08.05.2018 të Rektorit të UMB, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, krijuar me vendimin Nr. 38, datë 06.03.2016 të Rektorit të UMB dhe gjithashtu Këshilli i Vlerësimit të Performancës, i cili bashkëpunon me Zyrën e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë për të siguruar informacion për stafin akademik dhe vlerësim të performancës së tij.

Organizimi kryesor përgjegjës për monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë është Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, e cila ka si qëllim të ndjekë vijimësinë e proceseve themelore që ndikojnë në realizimin e plotë të procesit akademik dhe në zhvillimin afatshkurtër e perspektiv të kurrikulave universitare të UMB, proceset themelore të vlerësimit të cilësisë dhe akreditimeve programore e institucionale, mbështetur në dokumentacionin ligjor të arsimit të lartë dhe aktet nënligjore të MASR dhe aktet e tjera nënligjore, vendimore e udhëzuese të strukturave qeverisëse të institucionit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	SHLUJ UMB përdor një sërë instrumentesh matëse dhe vlerësuese si: formular për vlerësimin e lëndës dhe të pedagogut për studentët; raporte të vlerësimit të studentëve;
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion	

<p>në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>raporte vetë-vlerësimi për Senatin; raporte vetë-vlerësimi për Rektorin, rezultatet e të cilave përfshihen në raportet që Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë harton, në bashkëpunim me Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe Këshillin e Vlerësimit të Performancës. Rezultatet i bëhen me dije gjithashtu stafit akademik dhe studentëve.</p> <p>Institucioni ka të publikuar dokumentin e politikës së vlerësimit si dhe publikon rregullisht rezultatet e vlerësimit dhe objektivat e cilësisë në faqen zyrtare të internetit të IAL. Institucioni realizon një ndërthurje metodash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për kryerjen e vlerësimit, të brendshëm, me mekanizma të shumëfishtë vlerësimi për studentët, universitetin, intervista, dhe monitorim të mësimdhënies në auditor.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht</p>	<p>SHLUJ UMB, në përfundim të çdo viti akademik, publikon në faqen zyrtare të tij, raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore – shkencore, duke përfshirë edhe</p>

prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.	analizën SWOT dhe të dhënat e rezultatet e vlerësimit të brendshëm, shoqëruar me raportet dhe informacionin përkatës.
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimit.</p> <p>Politikat dhe procedurat që ndihmojnë në përmirësimin e programeve parashikohen në dokumentin e politikës së vlerësimit.</p>
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>SHLUIJ UMB është akredituar për herë të parë në nivel institucional me urdhërin Nr. 288 datë 04.09.2009 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe është riakredituar me Vendimin Nr. 9, datë 07.04.2017 të Bordit të Akreditimit.</p> <p>Institucioni përdor një sërë mekanizmesh cilësorë dhe sasiorë për përmirësimin e cilësisë si: monitorimin e procesit të mësimdhënies, vlerësimin e studentëve për çdo lëndë, feedback-un nga pedagogët dhe studentët për çdo lëndë, pyetësorë, etj.</p> <p>Organizmat përgjegjës që bashkëpunojnë në funksion të sigurimit të cilësisë janë Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë harton, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Këshilli i Vlerësimit të Performancës.</p> <p>Raportet analizohen në njësinë kryesore dhe problematikat e përgjithshme trajtohen në mbledhjet e Senatit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në UMB funksionojnë Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Këshilli i Vlerësimit të Performancës, të cilat bashkëpunojnë midis tyre për sigurimin e cilësisë në rang institucioni. 2. Institucioni përdor një sërë instrumentesh matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve. 3. Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimit. 4. Politikat dhe procedurat që ndihmojnë në përmirësimin e programeve përfshihen në dokumentin e politikës së vlerësimit. 	



POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca juridike”, me profile: “E drejtë publike”, “E drejtë biznesi” u ofrohet studentëve që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë “Bachelor” në përputhje me fushën e studimit dhe plotësojnë kushtet e pranimit specifikuar në Rregulloren e programit të studimit. Programi i studimit i ofron studentëve njohuritë e nevojshme për të përvetësuar kompetenca të avancuara shkencore dhe profesionale në fushën e biznesit dhe të së drejtës publike përmes metodave, instrumenteve dhe teknikave inovative. Përvetësimi i këtyre aftësive bëhet i mundur në sajë të thellimit të njohurive, që studentët marrin në programet Bachelor në fushën e Drejtësisë. Këto njohuri bazë thellohen më tej gjatë studimit në programet Master Profesional duke i zbatuar në planin metodologjik dhe aplikativ, në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të përballuar problematikat e ndryshme të fushës së studimit. Të diplomuarit në këtë program studimi do të marrin njohuri teoriko-praktike të nevojshme, me qëllim aftësimin e tyre për të zhvilluar veprimtarinë në institucione publike dhe private sipas fushave përkatëse; për të zhvilluar veprimtarinë në mënyrë të drejtpërdrejtë në firma të ndryshme private në fushën tregtare e publike; pas një periudhe praktike në profesion dhe studimeve të avancuara, aftësinë për të drejtuar. Duke parë zhvillimet e shpejta të legjislacionit dhe reformës në Drejtësi SHLUJ UMB është përpjekur që të ndjekë këto hapa edhe me përmirësimin dhe përditësimin e programit mësimor në fjalë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Programi i studimit funksionon që prej vitit akademik 2012-2013. Në këtë vit akademik është hapur vetëm profili “E drejtë biznesi”. Programi është i organizuar në një vit studimi, dy semetra, 15 javë secili prej tyre.

Objektivat e programit të studimit “E drejtë biznesi” janë:

Në fund të programit studenti duhet të zotërojë një formimin teorik në fushën të drejtës së publike. Të jetë i aftë të trajtojë në mënyrë të efektshme dhe pragmatike rastet nga biznesi. Të zotërojë teknikat e kërkimit dhe arsyetimit për të zgjidhur raste të ndërlikuara.

Objektivat e programit të studimit “E drejtë Publike” janë:

Në fund të programit studenti duhet të zotërojë një formimin teorik të specializuar në fushën të drejtës së biznesit. Të jetë i aftë të trajtojë në mënyrë të efektshme dhe pragmatike çështjet të së drejtës publike. Të zotërojë teknikat e kërkimit dhe arsyetimit për të zgjidhur raste të ndërlikuara administrative.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- | | |
|------------------|-----------------------------|
| > 1 vit akademik | 30 javë mësimore në auditor |
| > 1 Semestër | 15 javë mësimore në auditor |
| > 1 ECTS | 25 orë pune të studentit |
| > 1 orë mësimore | 60 minuta |



- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor sipas profileve paraqitet në Tabelat 13.1 dhe 13.2 të Anekseve. Nga analiza e ndarjes së ECTS sipas formave të mësimdhënies rezulton se për planin mësimor deri në vitin 2017-2018 përgjithësisht ka raporte të drejta ndërmjet formave të mësimdhënies. Përjashtim bën integrimi në një masë të pamjaftueshme i elementëve të tillë si detyra e projekte. Vihet re se mungojnë lëndët me zgjedhje.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit (RVB, fq. 58):

- Për Leksionet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 75 orë në auditor dhe 50 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 125 orë në auditor dhe 250 orë punë e pavarur e studentit

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Plani mësimor nuk ka pësuar ndryshime edhe pse një nga rekomandimet në akreditimin e parë ka qenë që të ofrohet një larmishmëri më e madhe e lëndëve që lidhen me fushat specifike të profileve të këtij programi studimi.

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabelat 15.1 dhe 15.2 të Anekseve)

Në profilin "*E drejtë publike*", në vitin akademik **2017-2018** personeli akademik efektiv mbulon **83.3 %** të ngarkesës totale mësimore. Në vitin akademik **2016-2017**, personeli akademik efektiv ka mbuluar **66.7 %** të ngarkesës totale mësimore. Në vitin akademik 2015-2016 ky profil nuk është hapur.

Në profilin "*E drejtë biznesi*", në vitin akademik **2017-2018**, i gjithë stafi akademik i angazhuar është staf efektiv dhe për rrjedhojë ngarkesa mësimore mbulohet **100 %** nga staf akademik efektiv. Në vitin akademik **2016-2017**, personeli akademik efektiv në këtë vit akademik ka mbuluar **58.3 %** të ngarkesës totale mësimore.

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset përmbajnë këto elementë bazë:

- Emërtimi i modulit/lëndës
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Titullari dhe emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, adresa elektronike e tij
- Tipi i lëndës në disiplinat A-F
- Kodi i lëndës
- Programi i studimit
- Objektivat e lëndës, njohuritë që lënda ka për qëllim të japë.
- Të gjitha temat që trajton lënda në aspektin teorik dhe praktik.
- Forma e vlerësimit të studentit
- Detyrimet e studentit
- Literatura e detyrueshme dhe ajo ndihmëse.

Vihen re disa mangësi në syllabuse si në literaturën ndihmëse dhe në tekste të cilat nuk janë të azhuruara ashtu edhe në javët e mësimi, ku disa prej syllabuseve janë me 12 javë.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

GVJ i shqyrtoi të gjitha syllabuset përkatëse të lëndëve të programit mësimor dhe rezultoi se ato janë hartuar sipas formatit të kërkuar me elementët bazë të tyre. Rezultoi se për një pjesë të syllabuseve ka mangësi si në literaturën ndihmëse dhe në tekste të cilat nuk janë ta azhornuara ashtu edhe në javët e mësimin, ku disa prej syllabuseve janë me 12 javë, por duhet theksuar që me rishikimin e planit mësimor pritët riorganizimi i tyre duke përfshirë edhe këta elementë. Përsa i përket përmbajtjes së tyre, GVJ vlerëson se ato paraqesin problematikën e lëndës duke iu përgjigjur objektivave të saj. Duke gjykuar se syllabuset janë në proces përmirësimi të përhershëm, GVJ rekomandon që ato të përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me kërkesat e tregut, si dhe me eksperiencat më të mira të universiteteve vendase dhe atyre të huaja.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit është akredituar me Urdhër Nr. 329 datë 07.08.2012 të MASH për një periudhë 6 vjeçare. Programi përfundon me diplomën Master Profesional dhe ofrohet i organizuar në module dhe vlerësuar në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore,</p>	<p>Programi i studimit Master profesional në “Shkenca juridike”, me profile: “E drejtë publike”, “E drejtë biznesi” synon pajisjen e të diplomuarve me njohuri të thelluara praktike, duke synuar një orientim më fleksibël drejt nevojave specifike të tregut.</p> <p>Programi i studimit ofron një formim solid në sektor të ndryshëm me interes të së drejtës së biznesit dhe të së drejtës publike, me aftësi në kërkimin shkencor duke integruar dhe zgjerimin e njohurive në këto fusha. Programi synon të përgatisë profesionistë të aftë në fushën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit.</p> <p>Programi ngrihet mbi bazën e programit bachelor në Drejtësi, por gjithashtu synon për një specializim të thelluar në këto fusha. Në këtë program avancohen njohuritë lidhur me ushtrimin e funksioneve publike dhe njohjet e hollësishme</p>

<p>teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>të studentit me teknikat e reja të informatikës ligjore, njohjen e tyre me kontratat tregtare, rëndësinë e lirisë kontraktore, etj.</p> <p>Programi krijon baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoraturë, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor. Programi ka caktuar në mënyrë të qartë objektiva të lidhura me nevojat e tregut të punës.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi, nëpërmjet moduleve të lëndëve, synon zgjerimin dhe thellimin e njohurive teorike, praktike dhe profesionale të studentëve si dhe njohjen e tyre me procesin e kërkimit shkencor. Modulet/lëndët e këtij programi ndërtohen mbi njohuri të fituara në ciklin e parë të studimeve dhe gjatë këtij cikli studimi studentët krijojnë baza të forta për të vazhduar studimet në ciklin e dytë.</p> <p>Metodat e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve përkatëse. Vlerësimi realizohet nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme dhe periodike si testet e ndërmjetme, detyra apo projekte kursi, pjesëmarrje aktive në seminare dhe provimi përfundimtar. Vlerësimi edhe përgjatë vitit mundëson një vlerësim sa më objektiv për arritjet dhe nivelin e dijeve të studentëve.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe</p>	<p>Nga takimet me pedagogët rezulton se programi i studimit është hartuar duke u mbështetur në përvojën e SHLUJ UMB dhe praktikat më të mira të universiteteve me të cilat Institucioni bashkëpunon.</p> <p>Programi përmban elemente që respektojnë standardet me të mira ndërkombëtare të kurrikulës universitare. Kjo kontribuon në</p>

<p>procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>mundësinë e transferimit të krediteve e niveleve të studimit për në dhe nga universitete të tjera në Europë e më gjerë.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë. Programi është bazuar në projektin evropian TUNING.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Aftësimi profesional i studentëve arrihet përmes kurrikulës që kombinon teorinë me aplikimin, me punësimin në procesin e mësimdhënies, të stafit me përvojë profesionale.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë e SHLUJ UMB –së.</p> <p>Puna kërkimore-shkencore e personelit akademik dhe lidhja e saj me përditësimin e programeve të studimit janë komponentë të pranishëm në SHLUJ UMB.</p> <p>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nëpërmjet RVB-së, dosjes përkatëse të universitetit, tregohet se SHLUJ UMB inkurajon aktivitetet kërkimore-shkencore të departamentit.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Mbështetur në kërkime të tregut të punës të realizuara nga SHLUJ UMB programi i studimit konsiderohet në përputhje me to. Reforma në drejtësi ndryshon panoramën ligjore të deritanishme dhe përgatitja e studentëve me korvizën e re ligjore është kthyer në domosdoshmëri për të plotësuar sektorët e ekonomisë vendase apo të huaj.</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të 	<p>Programi i studimit synon të kontribuojë në krijimin e një brezi të ri juristësh, të formuar sipas nevojave të kohës, në përputhje me nevojat e tregut të punës. Programi është hartuar dhe synon përmirësimin e tij në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, dhe përshtatjen me aktet ligjore e nënligjore.</p> <p>Institucioni ka kryer sondazhe dhe anketime për kërkesat e tregut vendas për specialistë në të drejtën publike dhe atë të biznesit për kërkesat e punëdhënësve. Për IAL mbetet detyrë përforcimi i marrëdhënies me bizneset, me qëllim krijimin e profilit të të diplomuarve sa më afër nevojave të tregut.</p> <p>Programi është ndërtuar duke synuar përgatitjen e</p>

<p>regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>specialistëve me kompetencat e kërkuara nga tregu i punës. Programi master profesional kombinon teorinë me praktikën duke u mundësuar studentëve të zhvillojnë aftësi të reja ndërkohë që ata edhe praktikohen.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Institucioni ofron programe studimi që janë në mbështetje të interesave kombëtare për një arsimim cilësor, me objektiv formimin e një brezi të ri intelektualësh.</p> <p>Programi Master është ndërtuar që t'i shërbejë ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare, të tilla si demokracia, diversiteti, shpirti i sipërmarrjes, toleranca, bashkëpunimi, drejtësia, respektimi i të drejtave të njeriut, zhvillimi i qëndrueshëm, integrimi evropian. Programi i trajton, mbështet dhe i kultivon këto vlera nëpërmjet përmbajtjes mësimore, kërkimit dhe veprimtarive.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezen që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Master Profesional në "Shkenca juridike", me profile: "E drejtë publike", "E drejtë biznesi" është 1 vit, e organizuar në 2 semestra. Forma e studimit është me kohë të plotë dhe studentët për t'u diplomuar duhet të realizojnë 60 kredite ECTS. Në planin mësimor të këtij programi studimi parashikohet që studenti në përfundim të studimeve duhet të realizojë një provë finale e cila vlerësohet me 15 kredite.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>N/A</p>

Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;

Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.

Syllabuset e të gjitha lëndëve u vihen në dispozicion studentëve në fillim të vitit akademik. Përmes tyre ata njihen me orët në auditor, ndarjen në leksione, seminare, dhe praktika, detyrimet që lidhen me frekuentimin dhe detyrime të tjera që lidhen me shlyerjen e lëndës sipas programit përkatës.
Informacioni për kurrikulën publikohet në fillim të vitit akademik në faqen zyrtare të internetit të SHLUJ UMB.

Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;

Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.

Rregullojra e Studimeve për Programin përcakton kushtet dhe procedurën e diplomimit. Plani mësimor ka parashikuar 15 kredite për provën finale, provim përfundimtar ose temë diplome për studentët me mesatare 9.5 sipas Udhezimit të Rektorit nr. 18, datë 18.01.2016.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i studimit Master Profesional në "Shkenca juridike", me profile: "E drejtë publike", "E drejtë biznesi" është hartuar në përputhje me misionin dhe strategjinë e SHLUJ UMB.
2. Ky program studimi bazohet në kurrikulën e programit bachelorit dhe është hartuar në përputhje me nivelin e studimeve master profesional.
3. Realizimi i programit mbështetet nga një staf PAE dhe PAK i motivuar dhe me nivel të lartë shkencor.
4. Studentët disponojnë gjithë informacionin për programin e studimit dhe japin kontributin e tyre në përmirësimin e tij. Çdo fillim semestri atyre u vihen në dispozicion kalendari dhe llojet e lëndëve që do të zhvillohen. Lektorit i lëndës në çdo fillim semestri shpjegon në mënyrë të detajuar përmbajtjen e lëndës, sistemin e vlerësimit për atë lëndë, detyrimet akademike për t'u vlerësuar, etj.
5. Për një pjesë të syllabuseve ka mangësi si në literaturën ndihmëse dhe në tekste të cilat nuk janë ta azhurnuara ashtu edhe në javët e mësimin, ku disa prej syllabuseve janë me 12 javë, por duhet theksuar që me rishikimin e planit mësimor pritët riorganizimi i tyre duke përfshirë edhe këta elementë. Duke gjykuar se syllabuset janë në proces përmirësimi të përhershëm, GVJ rekomandon që ato të përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me kërkesat e tregut, si dhe me eksperiencat më të mira të universiteteve vendase dhe atyre të huaja.
6. Vihet re se në këtë program studimi nuk parashikohen lëndë me zgjedhje.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Në SHLUJ UMB procesi mësimor është i organizuar në vite akademike. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore; studenti zhvillon deri në 25 orë mësimore në auditor/javë. Forma kryesore e mësimdhënies



është ajo e kombinimit të leksioneve, seminareve, prezantimeve të projekteve të studenteve, etj. Leksionet zhvillohen me ndihmën e mjeteve didaktike elektronike. Seminaret janë interaktive dhe kjo realizohet nëpërmjet rasteve studimore, ndarjes së punës në grup, prezantimeve të çështjeve specifike, etj. Vlerësimi ndahet në disa komponentë, megjithatë përqindjet variojnë sipas lëndëve dhe kritereve që përdoren. Studentët janë pjesë e disa projekteve të Fakultetit apo qendrave kërkimore të institucionit. Konstatohet mungesa e lëndëve me zgjedhje.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Forma kryesore e mësimdhënies është ajo e kombinimit të leksioneve, seminareve, prezantimeve të projekteve të studentëve, prezantimi i videove të ndryshme në varësit të temave, etj. Leksionet zhvillohen me ndihmën e mjeteve didaktike elektronike. Seminaret janë interaktive (të pasura me debate, teste, ushtrime praktike e profesionale). Interaktiviteti realizohet nëpërmjet rasteve studimore, ndarjes së punës në grup, prezantimeve të çështjeve specifike, etj. Vlerësimi ndahet në disa komponentë, megjithatë përqindjet variojnë sipas lëndëve dhe kritereve që përdoren. Të dhëna për ngarkesën në auditor sipas formave të mësimdhënies paraqiten në tabelën 16 të Aneksëve.

- Format e kontrollit të njohurive:

Format e kontrollit të njohurive përfshijnë disa komponentë: Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive (20%); Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) (30 %); dhe provimin përfundimtar (50%). Këto të dhëna paraqiten në tabelën 17 të Aneksëve.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Numri i studentëve të aktivizuar ka qenë rreth 24, duke përfshirë këtu punë kërkimore individuale të pedagogëve të departamentit, projekte shkencore në nivel departamenti ose në nivel fakulteti. Pranë institucionit funksionojnë disa njësi të tjera ndihmëse (në formë OJF), si Youth Act, Adipoli dhe AIPA, të cilat zhvillojnë projekte të natyrave të ndryshme, të financuara nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Për të ndjekur programin e studimit Master Profesional në "Shkenca juridike", me profile "E drejtë biznesi" dhe "E drejtë publike", studenti duhet të ketë përfutur një diplomë të ciklit të parë Bachelor, në përputhje me fushën e studimit. Institucioni ka ndërtuar një numër kriteresh dhe procedurash standarde të pranimit, si: i) zotërimin e një diplome universitare "Bachelor" ose diplomë tjetër studimi të fituar brenda apo jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të në fushën përkatëse ose në fusha të përafërta me programin për të cilin aplikon. Në rastin kur diploma nuk përputhet me fushën e programit të kërkuar, departamenti që mbulon programin përkatës të studimeve master vlerëson nëse kualifikimet dhe përvoja në fushë janë të mjaftueshme apo përcakton nëse kandidati duhet të realizojë një program përafrimi. ii) notë mesatare të studimeve universitare "Bachelor" 6.00 ose më e madhe. iii) të arrijë rezultate të mira në çdo testim pranimit ose intervistë të kërkuar nga departamenti. iv) Të

shprehë qartë qëllimin e ndjekjes së studimeve në programin Master Profesional; v) Të rekomandohet nga dy persona të cilët i njohin aftësitë akademike, profesionale, kërkimore dhe personale të kandidatit; vi) të provojë se është në gjendje të plotësojë nevojat financiare të studimit. Institucioni, bazuar dhe në kriteret e Bolonjës, mund të pranojë transferimin e studentëve në të njëjtin nivel studimor nga universitete të tjera vendase ose të huaja, sipas procedurave dhe dispozitave në fuqi.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Për profilin “E drejtë biznesi”:

Në vitin akademik 2012 – 2013, janë regjistruar 22 studentë, me notë mesatare në hyrje 7.7, të cilët kanë rezultuar me një kalueshmëri 72.73% dhe notë mesatare 8.3 në dalje. Në vitin akademik 2013 – 2014, janë regjistruar 13 studentë, me notë mesatare në hyrje 8.1, të cilët kanë rezultuar me një kalueshmëri 61.5% dhe notë mesatare 8.1 në dalje. Në vitin akademik 2014 – 2015, janë regjistruar 22 studentë, me notë mesatare në hyrje 7.5, të cilët kanë rezultuar me një kalueshmëri 50% dhe notë mesatare 7.4 në dalje. Në vitin akademik 2015 – 2016, nuk ka studentë të regjistruar në këtë profil. Në vitin akademik 2016 – 2017, janë regjistruar 10 studentë, me notë mesatare në hyrje 7, të cilët kanë rezultuar me një kalueshmëri 70% dhe notë mesatare 8.1 në dalje. Në vitin akademik 2017 – 2018, janë regjistruar 6 studentë, me notë mesatare në hyrje 7.3.

Për profilin “E drejtë publike”:

Në vitin akademik 2012 – 2013 ky profil nuk është hapur. Në vitin akademik 2013 – 2014, janë regjistruar 9 studentë, me notë mesatare në hyrje 7.5, të cilët kanë rezultuar me një kalueshmëri 66.7% dhe notë mesatare 8 në dalje. Në vitin akademik 2014 – 2015 dhe 2015-2016 nuk ka patur studentë të regjistruar në këtë profil. Në vitin akademik 2016 – 2017, janë regjistruar 9 studentë, me notë mesatare në hyrje 7, të cilët kanë rezultuar me një kalueshmëri 77.8% dhe notë mesatare 8.6 në dalje. Në vitin akademik 2017 – 2018, janë regjistruar 7 studentë, me notë mesatare në hyrje 6.7.

Për profilin “E drejtë biznesi”:

Në vitin akademik 2012 – 2013, janë diplomuar 16 studentë; kalueshmëria është 72.73% dhe nota mesatare në dalje është 8.3. Në vitin akademik 2013 – 2014, janë diplomuar 8 studentë; kalueshmëria është 61.5% dhe nota mesatare në dalje është 8.1. Në vitin akademik 2014 – 2015, janë diplomuar 11 studentë; kalueshmëria është 50% dhe nota mesatare në dalje është 7.4. Në vitin akademik 2015 – 2016, nuk ka studentë të regjistruar në këtë profil. Në vitin akademik 2016 – 2017, janë diplomuar 7 studentë; kalueshmëria është 70% dhe nota mesatare në dalje është 8.1.

Për profilin “E drejtë publike”:

Në vitin akademik 2012 – 2013 ky profil nuk është hapur. Në vitin akademik 2013 – 2014, janë diplomuar 6 studentë; kalueshmëria është 66.7% dhe nota mesatare në dalje është 8. Në vitin akademik 2014 – 2015 dhe 2015-2016 nuk ka patur studentë të regjistruar në këtë profil. Në vitin akademik 2016 – 2017, janë diplomuar 6 studentë; kalueshmëria është 77.8% dhe nota mesatare në dalje është 8.6.

SHLUIJ UMB mundëson transferimin e studentëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të dytë, midis programeve të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, private ose publike, vendase ose të huaja, si dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera të arsimit të lartë sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e programit (Kreu III Pranimi i studenteve) dhe në rregulloren e transferimeve. Në këtë program ka vetëm 1 studentë të transferuar, në vitin akademik 2014-2015, në profilin “E drejtë biznesi”.

Për profilin “E drejtë publike”: Në vitin akademik 2012-2013 janë 7 studentë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 2 të punësuar jo në përputhje me diplomën. Në vitin akademik 2013-2014 janë 3 studentë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 5 studentë jo në përputhje me diplomën. Në vitin akademik 2014-2015 janë 7 studentë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 3 jo në përputhje me

diplomën. Në vitin akademik 2016-2017 janë 2 studentë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 3 jo në përputhje me diplomën. Në total për këtë profil janë 19 të punësuar në përputhje me diplomën dhe 13 të punësuar jo në përputhje me diplomën.

Për profilin “E drejtë biznesi”: Në vitin akademik 2013-2014 janë 3 studentë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 1 student jo në përputhje me diplomën. Në vitin akademik 2016-2017 janë 4 studentë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 2 jo në përputhje me diplomën. Në total për këtë profil janë 7 të punësuar në përputhje me diplomën dhe 3 të punësuar jo në përputhje me diplomën.

Numri total i të diplomuarve në profilin “E drejtë biznesi”, për vitet akademike 2013 - 2018 është 13 studentë. Numri total i të diplomuarve në profilin “E drejtë publike”, për vitet akademike 2013 - 2018 është 42 studentë. Numri total i të diplomuarve në programin MP. Shkenca juridike, me profile, për vitet akademike 2013-2018 është 55 studentë.

Për profilin “E drejtë publike”: Në vitin akademik 2012-2013 janë 7 studentë të punësuar në përputhje me diplomën. Në vitin akademik 2013-2014 janë 3 studentë të punësuar në përputhje me diplomën. Në vitin akademik 2014-2015 janë 7 studentë të punësuar në përputhje me diplomën. Në vitin akademik 2016-2017 janë 2 studentë të punësuar në përputhje me diplomën. Në total për këtë profil janë 19 të punësuar në përputhje me diplomën.

Për profilin “E drejtë biznesi”: Në vitin akademik 2013-2014 janë 3 studentë të punësuar në përputhje me diplomën. Në vitin akademik 2016-2017 janë 4 studentë të punësuar në përputhje me diplomën. Në total për këtë profil janë 7 të punësuar në përputhje me diplomën.

Për profilin “E drejtë publike”: Në vitin akademik 2012-2013 janë 2 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën. Në vitin akademik 2013-2014 janë 5 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën. Në vitin akademik 2014-2015 janë 3 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën. Në vitin akademik 2016-2017 janë 3 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën. Në total për këtë profil janë 13 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën.

Për profilin “E drejtë biznesi”: Në vitin akademik 2013-2014 është 1 student i punësuar jo në përputhje me diplomën. Në vitin akademik 2016-2017 janë 2 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën. Në total për këtë profil janë 3 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të</p>	<p>Pranimi në programet master profesional në SHLUJ UMB bëhet në përputhje me kërkesat në fuqi për pranimet në arsimin e lartë. Pranohen ata studentë që zotërojnë diplomë universitare Bachelor dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Pranohen për t’u regjistruar në programin e studimeve të ciklit të dytë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Rregulloren përkatëse të Programit të Studimit. Departamenti bën perzgjedhjen e studentëve bazuar edhe në të dhënat e tyre personale.</p> <p>Mbështetur në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e</p>

<p>studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe specifikimeve të tij për pranimin në programet e studimit master profesional, kërkesa për njohjen e certifikuar të gjuhës së huaj nuk është kriter pranimi. (Vendimi i Senatit të SHLUJ UMB 7/16, dte 11.05.2016).</p> <p>SHLUJ UMB ka vlerësuar dhe vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe i ka ndryshuar ato në përputhje me ndryshimet që i janë bërë legjislacionit të arsimit të lartë, kërkesave të tregut të punës dhe standardeve të cilësisë së institucionit.</p>
---	--

Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.

<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>SHLUJ UMB jep informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit, në përfundim të programeve të studimit, në forma të ndryshme. Janë dy zyra të cilat u japin informacion studentëve mbi shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra e Alumnit dhe Zyra e Karrierës siguron një pikë fokusimi për studentet, komunitetin e gjerë universitar dhe botën e punës.</p> <p>Studentëve u bëhet i njohur informacioni mbi akreditimin e programit që në kontaktin e parë me institucionin.</p> <p>SHLUJ UMB ka marrëveshje bashkëpunuese me të cilat realizon edhe kryerjen e praktikës profesionale. Marrëdhëniet që vendosin studentët me këto shoqëri gjatë viteve të studimit janë të tilla që krijojnë marrëdhënie reciproke çka mund të çojë edhe në mundësi konkrete punësimi.</p>
---	---

Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>SHLUJ UMB ka statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar. Për vitin akademik 2017-2018 në profilin “E drejtë publike” janë regjistruar 7 studentë, ndërsa në profilin “E drejtë biznesi” 6 studentë. SHLUJ UMB ka statistika vjetore të plota. SHLUJ UMB ka të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim. Të dhënat janë të regjistruara në Regjistrin themeltar, Regjistrin e rezultateve akademike, Regjistrin e diplomave, të verifikuara edhe gjatë vizitës në Institucion në Sekretarinë Mësimore.</p>
--	---

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;

Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.

SHLUJ UMB ka një bazë të dhënash për punësimin e studentëve pas diplomimit të tyre e cila përditësohet në mënyrë të vazhdueshme.

Aktualisht SHLUJ UMB bashkëpunon me Clemson University për doktoraturën që ky universitet ofron në Shqipëri dhe në kuadrin e përgjegjësi administrative ka një bazë të dhënash për studentet që ndjekin studimet doktorale.

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;

Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;

Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.

Studentët e programit të studimit nëpërmjet Sekretarisë mësimore, pedagogëve të lëndëve dhe Departamentit informohen në lidhje me programet e studimit të zgjedhura prej tyre, afatin e përfundimit të programit, mënyrën e organizimit të programit, të lëndëve përkatëse si dhe statusin e akreditimit të programeve. Gjithashtu këto të dhëna janë të publikuara në faqen eeb.

Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë programit dhe informohen edhe në përfundim të programit.

Pas çdo provimi publikohen rezultatet paraprake për çdo student. Studentëve u lihet një afat për ankimimet e mundshme lidhur me rezultatet e provimit. Pedagogu i çdo lënde diskuton me studentët për rezultatet e këtyre vlerësimeve. Nota përfundimtare vendoset mbas këtij procesi.

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

SHLUJ UMB i ndihmon studentët për çështje të procesit mësimor nëpërmjet këshillimit që ofron Zyra e Alumnit dhe Karrierës. Zyra e Alumnit, Karrierës dhe koordinatori i programit u japin ndihmë studentëve në përzgjedhjen e institucioneve qendrore si dhe zyra të ndryshme për realizimin e praktikës mësimore.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. SHLUJ UMB i kushton një vëmendje të veçantë studentit duke e ndjekur, këshilluar e orientuar që në procesin e regjistrimit e deri në atë të punësimit. Departamenti, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës, Alumnit dhe Sekretarinë Mësimore disponon të gjitha statistikat e nevojshme për programet e studimit. Departamenti bashkëpunon me Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve për të informuar dhe koordinuar studentët dhe stafin akademik për një procedim sa më efektiv të të gjithë procesit

- mësimor.
2. Departamenti i Drejtësisë vë në dispozicion të studentëve të interesuar për të ndjekur këtë program studimi, grupe pedagogësh, sipas drejtimit të programit, për të dhënë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit, rregulloren e universitetit, mundësitë e punësimit, mundësitë e transferimit të krediteve, etj.
 3. Gjatë vizitës në Institucion, u konstatua se në temat e diplomave të studentëve, për profilin “E drejtë biznesi”, përdorej emërtimi “E drejtë tregtare”.
 4. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve, Zyra e Karrierës dhe Alumnit, me aktivitetet e tyre, mbulojnë kërkesat e studentëve dhe shërbejnë si një urë e mirë dhe e qëndrueshme lidhjeje ndërmjet studentëve që përfundojnë studimet në SHLUJ UMB dhe punëdhënësve.
 5. Duhet të bëhet më shumë për të përthithur studentë me rezultate të larta, kjo do të rriste më shumë nivelin e studentëve të diplomuar dhe një përfshirje më të madhe të tyre në ciklin e tretë të studimeve.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Sipas përcaktimeve të RVB-së, SHLUJ UMB është institucion i Arsimit të Lartë i orientuar nga mësimdhënia dhe kërkimi shkencor. Veprimtaria kërkimore shkencore në SHLUJ UMB është e organizuar dhe zhvillohet në zbatim të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Institucioni synon që kërkimi shkencor të jetë pjesë e integruar e veprimtarisë së tij dhe synon që nëpërmjet kërkimit shkencor:

- Të trajtojë problemet kryesore që lidhen me interesat e drejtëperdrejta të të gjithë anëtarëve të shoqërisë;
- Të përdorë perspektivat ndërkombëtare krahasuese në edukim, duke zhvilluar vlerat e shanseve të barabarta dhe të mirën e përbashkët;
- Të kontribuojë në reformat në sektorin publik, në kuptimin e marrëdhënieve dhe lidhjeve midis teorisë dhe praktikës në arsimin, duke e vënë theksin në mënyrë të veçantë tek lidhja midis edukimit dhe çështjeve sociale;
- Të rrisë standardin e kërkimit duke promovuar standardet më të larta në cilësinë e kërkimit si dhe integritetin etik në punën kërkimore, orientimin e kërkimit në të gjitha fushat dhe kategoritë, të përcjellë debatet publike për edukimin nëpërmjet kontributit të pavarur të mbështetur në punën kërkimore duke mirëpritur dhe mbështetur partneritetin me agjencitë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim që të promovojë të mirat në edukim.

Stafi akademik i UMB realizon punë kërkimore shkencore kryesisht staf i angazhuar pranë qendrave, departamenteve apo instituteve, si punonjës kryesor kërkimore shkencorë, lektorë apo koordinatorë projektesh kërkimore.

SHLUJ UMB ka krijuar infrastrukturën e nevojshme për të nxitur dhe mbështetur veprimtarinë kërkimore shkencore ndërdisiplinore cilësore të strukturave të UMB-së, instituteve SHLUJ UMB, AIPA, BIRD dhe IEB, të cilat synojnë të bashkëpunojnë me institucione të tjera kërkimore shkencore si dhe agjensitë e zhvillimit në rajon e më gjerë për organizimin e veprimtarive të përbashkëta si dhe

të bëhen pjesëmarrës aktivë në rrjetet ndërkombëtare të institucioneve të kërkimit të zhvillimit shkencor.

E gjithë veprimtaria kërkimore si dhe kualifikimet e stafit pasqyrohen dhe do të vazhdojnë të pasqyrohen në përditësimin në mënyrë të vazhdueshme të kurrikulave të SHLUJ UMB.

Institutet mundësojnë formimin dhe trajnimin e studentëve të UMB nëpërmjet kurseve dhe moduleve të ofruara në fushat e veprimtarisë së qëndrave kërkimore - shkencore të tij dhe strukturave të tjera të UMB.

Universiteti dhe institutet ofrojnë për studentet e të gjitha niveleve informacione për mundësitë që ofrohen për kualifikimin e tyre nga universitete dhe qendra të tjera kërkimore edhe shkencore brenda dhe jashtë vendit si dhe i mbështesin ata në procesin e aplikimit.

Studimet dhe hulumtimi i zhvilluar nga stafi akademik i UMB publikohen periodikisht në revistën "Gjeopolitika" si dhe në revista të tjera të njohura ndërkombëtarisht. Revista "Gjeopolitika" publikohet një herë në gjashtë muaj duke u fokusuar në çështje tematike të rëndësishë bashkëkohore.

Me rëndësi të vecantë është edhe akreditimi nga institucione ndërkombëtare i dy kategorive, Katedra Zhan Mone dhe ajo e UNESCO-s.

Të dhëna për kërkimin shkencor jepen në tabelën 21 të Anekseve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik është i angazhuar në publikimin e artikujve dhe merr pjesë në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore. Nëpërmjet angazhimit në veprimtari apo aktivitete të ndryshme shkencore personeli akademik i këtij programi studimi jep kontributin e tij në zhvillimin e shkencës.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi e zhvillon procesin mësimor në gjuhën shqipe.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e</p>	<p>Institucioni ofron mbështetje për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik dhe mbështetje për aftësimin për përdorimin e metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies, për hartimin e programeve lëndore. IAL, nëpërmjet Institutit të Edukimit Barleti dhe Prorektorit për</p>

<p>kualifikimeve të mëtëjshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>kërkimin shkencor dhe studimet pasuniversitare, organizon trajnime të stafit akademik me fokus metodat bashkëkohore të mësimdhënies, për hartimin e programeve lëndore, prirjet e zhvillimit në arsimin e lartë etj.</p> <p>SHLUJ UMB ofron mundësinë të kualifikimeve të mëtëjshme duke qene pjesë e trajnimeve të organizuar në kuader të projekteve si p.sh. Projekti Tempus për trajnimin e stafit mbi të drejtat e njeriut dhe integrimin e të drejtave ne arsimin e lartë.</p>
---	---

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

SHLUJ UMB disponon të dhëna për studimet shkencore, tekstet, monografitë, librat, artikujt apo kumtesat në konferenca si dhe të dhëna për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në programet e studimit. Këto të dhëna azhurnohen periodikisht.

SHLUJ UMB disponon një bazë të dhënash për botimet shkencore brenda dhe jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Këto të dhëna azhurnohen periodikisht në rang Departamenti.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Personeli akademik është i angazhuar në publikimin e artikujve dhe merr pjesë në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore. Duhet një angazhim më i madh për integrimin e studentëve në kërkimin shkencor.
2. Në mbështetje të kërkimit shkencor SHLUJ UMB, nëpërmjet revistës shkencore "Gjoepolitika", i mundëson stafit akademik të botojë në të artikujt shkencorë.
3. Institucioni ofron mundësinë e kualifikimeve të mëtëjshme duke qene pjesë e trajnimeve të organizuara në kuadër të projekteve si p.sh. Projekti Tempus për trajnimin e stafit mbi të drejtat e njeriut dhe integrimin e të drejtave në arsimin e lartë.
4. Institucioni disponon një bazë të dhënash për pjesëmarrjen në konferenca shkencore dhe botimet e realizuara nga personeli i tij akademik, brenda dhe jashtë vendit.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Institucioni ka zhvilluar një sërë bashkëpunimesh me institucione në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto bashkëpunime konsistojnë në trajnime, praktika të studentëve, pjesëmarrje në projekte, aktivitete të përbashkëta, etj. Ndër institucionet mund të përmendim: ministritë, bankat, organizatat e shoqërisë civile, bizneset dhe korporatat e mëdha, Akademia e Shkencave, universitete, studio ligjore, unionin e gjyqtarëve, etj. Në nivel ndërkombëtar Institucioni ka zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi shkencor me institucione nga Kosova, Maqedonia, SHBA, Italia, Mbretëria e Bashkuar, etj. Këto marrëveshje kanë kontribuar ndjeshëm në krijimin e rrjeteve të gjera për tregun e punës. SHLUJ UMB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe me institucione qëndrore, Gjykatën e Shkallës së Parë, Shërbimin e Provës, Avokatin e Popullit, etj. në funksion të realizimit të praktikës profesionale.

Në mënyrë të detajuar komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë jepen në tabelat 22 dhe 23 të Anekseve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

Të dhëna të detajuara mbi marrëveshjet e lidhura me institucione shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit etj. paraqiten në tabelat 22 dhe 23 të Anekseve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>SHLUJ UMB zhvillon një bashkëpunim të gjerë me një numër institucioneve shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, etj. Kjo kontribuon jo vetëm në realizimin e suksesshëm të praktikave të ndryshme, por edhe për kontakte me tregun e punës me qëllim punësimin e studentëve të diplomuar.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton</p>	<p>Institucioni nxit bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe hallkave institucionale brenda tij. Një formë tjetër e bashkëpunimit zhvillohet në nivel departamenti, me mbledhjet periodike dhe komunikimin e mundësive të bashkëpunimit për kërkime ndërmjet stafit.</p>

marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtijshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni, për të realizuar objektivat e programeve të tij, ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me universitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorët tjerë institucionalë dhe të biznesit.</p> <p>Këto bashkëpunime konsistojnë në trajnime, praktika të studentëve, pjesëmarrje në projekte, aktivitete të përbashkëta, etj.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni zhvillon një bashkëpunim të konsiderueshëm me një numër institucionesh shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, etj. të cilat konsistojnë në kuadër të realizimit të praktikave të studentëve, trajnimeve, organizimit të aktiviteteve të përbashkëta, pjesëmarrjes në projekte, etj. 2. Institucioni nxit bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe hallkave institucionale brenda tij. 	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

Pika të forta:

1. Programi i studimit është hartuar në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit dhe bazohet në një plan strategjik për zhvillimin dhe përmirësimin e tij.
2. Pedagogët e angazhuar në këtë program studimi janë të specializuar në përputhje me fushën studimore të këtij programi studimi.
3. Angazhim i institucionit për të rritur numrin e personelit akademik efektiv me tituj dhe grada, për një mësimdhënie sa më cilësore në këtë program studimi është për tu vlerësuar.
4. Në funksion të përmirësimit të sigurimit të cilësisë, institucioni është përfshirë në projektin Erasmus+ QAINAL.
5. Vihet re një bashkëpunim i konsiderueshëm me një numër institucionesh shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, të cilat rrisin cilësinë e realizimit të praktikave të studentëve, trajnimeve, organizimit të aktiviteteve të përbashkëta, pjesëmarrjes në projekte, etj.

Pika të dobëta:

1. Biblioteka ofron një numër të kufizuar titujsh për të mbuluar programin e studimit.

2. Në disa prej syllabuseve mungon literatura ndihmëse dhe në disa të tjera lind nevoja për përditësimin e tyre.
3. Nuk janë të përfshira në planin mësimor lëndë me zgjedhje, të cilat konsiderohen të rëndësishme sidomos për këtë program që është i konceptuar edhe me profile.
4. GVJ konstaton se, në temat e diplomave të studentëve, për profilin “E drejtë biznesi”, përdoret emërtimi “E drejtë tregtare”.

Mundësitë:

1. Mundësia e rishikimit të planit mësimor për të përfshirë në të lëndë që lidhen me fushat specifike të profileve të programit (Lënë si rekomandim edhe në akreditimin e parë).
2. Përditësimi i bibliotekës online me libra dhe literaturë bashkëkohore.
3. Mundësia e diversifikimit të burimeve të financimit në të ardhmen.
4. Mundësia për të përthithur studentë me rezultate të larta, e cila do të rriste më shumë nivelin e studentëve të diplomuar.

Pengesat:

1. Pasurimi me literaturë shkencore në fushën juridike në gjuhën shqipe. Për këtë duhet inkurajimi i pedagogëve për të botuar libra në fushat përkatëse por sidomos në atë të së drejtës së biznesit.
2. Rritja e konkurrencës si rezultat i ofrimit të programeve në fushën e së drejtës publike dhe të së drejtës së biznesit në Institucionet e tjera të arsimit të lartë në vend.

Rekomandime:

1. Të shikohet mundësia e rishikimit të planit mësimor për të përfshirë në të një larmishmëri të lëndëve që lidhen me fushat specifike të profileve të programit.
3. Përshtatja e syllabuseve me kërkesat e tregut si dhe me eksperiencat më të mira të institucioneve të arsimit të lartë si vendase ashtu edhe të huaja.

SUMMARY ANALYSIS OF THE STUDY PROGRAM IMPLEMENTATION

Comprehensive analysis of the EER according to the SWOT method (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats).

Strengths:

1. The study program is designed in accordance with the mission and objectives of the institution and is based on a strategic plan for its development and improvement.
2. The lecturers engaged in this study program are specialized in accordance with the study area of this study program.
3. The commitment of the institution to increase the number of academic staff with titles and degrees, for a qualitative teaching in this study program has to be recognized.
4. In order to improve the quality assurance, the institution has been involved in the Erasmus + QAINAL project.
5. There is a considerable cooperation with a number of state institutions, professional organizations, business community, which increase the quality of students practices, trainings, organization of joint activities, participation in projects, etc.

Weaknesses:

1. The library offers a limited number of titles to cover the study program.

2. In some of the syllabuses, there is a lack of recommended literature and in some others there is a need to update them.
3. In the curricula of the study program is a lack of elected subjects, which are considered important especially for this program that is also offered with profiles.
4. EEG finds that in the thesis of students, for the "Business Law" profile was used the name "Commercial Law".

Opportunities:

1. The possibility of revising the curriculum to include subjects related to specific areas of the program profiles (Has also been a recommendation in the first accreditation).
2. Updating the online library with contemporary books and literature.
3. The possibility of diversification of funding sources in the future.
4. The chance to absorb high-performing students, which would increase the level of graduate students.

Threats:

1. Enrichment with scientific literature in the legal field in Albanian language. For this reason, encouraging lecturers to publish books in relevant fields, but especially in business law.
2. Increase of competition as a result of the provision of programs in the field of public law and business law in other institutions of higher education in the country.

Recommendations:

1. To consider the possibility of reviewing the curriculum to include a variety of subjects related to specific areas of program profiles.
2. Adjustment of syllabuses to market requirements and the best experiences of higher education institutions both domestic and foreign.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc.Dr. Alketa Elezi

